



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

**Thirrje për ekspertë për përgatitjen e raportit tematik dhe periodik të Observatorit të Mësimit të Historisë në Evropë.**

Këshilli i Evropës, nëpërmjet Observatorit të Mësimit të Historisë, ka shpallur dy thirrje për ekspertë për përgatitjen e raportit tematik dhe periodik.

**Raporti tematik** lidhet me mënyrën sesi reflektohen pandemitë dhe fatkeqësitë natyrore në mësimin e historisë. Kandidatët duhet të kenë eksperiencë në fushën e historisë. Përgatitja e raportit tematik është parashikuar të përfundojë në muajin maj 2022. Observatori i Mësimit të Historisë në Evropë kërkon të angazhojë një grup ekspertësh, në përbërje të të cilit duhet të jenë maksimalisht tre ekspertë.

**Raporti periodik** do të përqëndrohet përgjithësisht në situatën e mësimit të historisë në Evropë, duke u përqëndruar në programet e historisë, praktikave pedagogjike dhe rezultateve të të nxëniet në 17 shtetet anëtare të Observatorit. Përgatitja e raportit periodik është parashikuar të përfundojë në muajin maj 2023. Për përgatitjen e këtij raporti, kërkohet të angazhohet një grup ekspertësh, në përbërje të të cilit duhet të jenë maksimalisht pesë ekspertë.

Dy grupet e punës do të bashkëpunojnë me Këshillin Këshillimor Shkencor të Observatorit, i cili do të miratojë raportet përpara publikimit të tyre.

Gjetjet e dy raporteve do të prezantohen në konferencën vjetore 2022.

Afati për aplikim në këto dy thirrje është deri më 15 shtator 2021, ora 23:59 (HEC).

**Për tu njohur me procedurën e aplikimit për të dyja thirrjet e lartpërmendura, ju lutem të klikoni në linkun e mëposhtëm të Këshillit të Evropës:**

<https://www.coe.int/en/web/observatory-history-teaching/-/ohte-launches-calls-for-experts-for-thematic-and-regular-reports>